



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot.

Fier, më / 12/ 2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mbrotja e digës së rezervuarit Libofshë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për diga - 45247210-5

Punime ndërtimi për përforsim digash - 45247212-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 602 795 (nëntë milion e gjashtëqind e dy mijë e shtatëqind e nentëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2020, 2021**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **3 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që*

*operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: **Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.***

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”;*

Duke qenë se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurimet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **2 000 000 lekë pa TVSH** (*e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 30% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet*), që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit eshte jo me pak se **9 000 000 leke pa TVSH** (*e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Aktin e kolaudimit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Fatura tatimore përfundimtare.

Ne rastin e paraqitjes se ofertave nga bashkimi i operatoreve, pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo me pak se **2 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 30% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) për një objekt të vetëm, ose jo me pak se **9 000 000 leke pa tvsh** (e cila është një vlerë jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet), për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor kërkon kontrate te ngjashme ne vlere 30 % te vleres se perlllogaritur te kontrates, pasi vlera e parashikuar e kontratës është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme si dhe referuar metodave të përforcimit të objekteve sipas projektit zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.

a) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierin e mëposhtëm:

- 1.** Inxhinier ndërtimi/Hidroteknik 1 (një)

Inxhinieri i mesiperm duhet të figuroj si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **Tetor 2022**. Për inxhinierin duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme).

b) Operatori/ët ekonomik ofertues, per realizimin e kesaj kontrate, duhet te kete ne stafin e tij **ose** me kontrate pune te vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates, edhe inxhinieret si më poshtë:

1. Inxhinier topograf/gjeodet 1 (një);
2. Inxhinier gjeolog 1 (një);

Për Inxhinieret e sipercituar duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme).

c) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontrate pune te vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates specialistë te certifikuar sipas profesioneve, te pakten si me poshte:

- Automakinist 2 (dy)
- Eskavatorist 1 (një)
- Buldozerist 2 (dy)

Për specialistet e sipercituar duhet të paraqiten deshmi/certifikate ose cdo dokument tjetër qe verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre, si dhe kontrate individuale e punës e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te zbatimit te punimeve.

d) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontrate pune te vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates specialist i certifikuar sipas profesionit, te pakten si me poshte:

- Mekanik 1 (një) (per montimin e portes se shkarkuesit)

Per specialistin duhet te paraqesin:

- Kontrate pune te vlefshme,
- Dokument qe te vertetoje kualifikimin sipas profilit te kerkuar (diplome ose certifikate profesionale ose deshmi kualifikimi, etj.)

Shënim: Për pikat **a), b), c) dhe d** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a), b), c) dhe d** të pikes **2.3.2**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Inxhinier gjeolog është vendosur gjithashtu bazuar dhe në vendimin e Komitetit Kombëtar të Digave të Medha nr.26 datë 24.10.2022 me nr.103 prot date 24.10.2022 „për projektin e zbatimit për riparime në digën e Libofshes“ dërguar me shkresë nr.108 prot date 04.11.2022 e cila është protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.9791 prot date 09.11.2022.

Autoriteti Kontraktor (njësia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **Tetor 2022** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe të pagesës*), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

2.3.3 Operatori/ët Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **15 punonjës** duke përfshirë edhe stafin e përhershëm, për **muajin Tetor 2022.**

Shënim: Për pikën **2.3.3** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.3**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Tetor 2022.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Tetor 2022.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), 6/ç) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në K.Punës dhe VKM nr.629 datë 15.07.2015 « për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre », në legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **Tetor 2022** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklaramit dhe të pagesës*), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

2.3.4 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - a. N.P-1 –A Punime germimi në tokë
 - b. N.P-6–A Diga dhe tunele hidroteknike
 - c. N.S-18–A Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P-1	Punime germimi në tokë	Per zërat e preventivit që përfshihen në të gjithë kapitujt	A

NP – 6	Diga dhe tunele hidroteknike	Per punimet e preventivuar ne Kap.I ne zerat e punes nr.,5,6,7,8 , Kap.II per zerat e punes 12,13,14, Kap. III per zerin e punes 18, Kap. V per zerin e punes 41,42,43,44,45	A
NS-18	Punime topogjeodezike	Per punimet e preventivuar ne Kap.II per zerat e punes nr.,13,14 , Kap.III per zerat e punes 18,19, Kap. IV per zerat e punes 28,29,30, Kap. V per zerin e punes 41,42,44,	A

2.3.5 Operatori/ët ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:

a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates sipas tabelës me poshte (*sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.8*):

NR	EMERTIMI I MAKINERISE	NR I MAKINERIVE	STATUSI
1	Autoveteshkarkuese 10 ton min	1	Në pronësi ose me qera
2	Buldozer 100k/f	1	Në pronësi ose me qera
3	Ekskavator me goma me kove 0.25 m3	1	Në pronësi ose me qera
4	Betoniere 500 l	1	Në pronësi ose me qera
5	Rul me vibrim, rul me dhembe, rul me cilindrik(duke u kombinuar)	1	Në pronësi ose me qera
6	Grejder	1	Në pronësi ose me qera
7	Tokmak elektrik	1	Në pronësi ose me qera

b) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion, mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve dhe personelit (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (*sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.8*):

- Kokore, minimum 10 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.

- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 4 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.

Shënim: Për pikën **2.3.5 (a dhe b)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 (a dhe b)**, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.**
- Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.**
- Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me **Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme)**, leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë

elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me originalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, VKM nr.629 date 15.07.2015 « per miratimin e maualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe analizave teknike te tyre , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kerkesat per disponimin ose mundësinë e sigurt te disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike te kerkuara ne kete kerkese per kualifikim, bazohet edhe ne nevojen per mundesine e sigurte te disponimit te mjeteve qe AK kerkon nga OE, te cilet duhet te vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si per mjetet qe do te angazhohen ne zbatimin e kontrates, ashtu edhe per kapacitet teknike qe lidhen me gadishmerine per plotesimin e tyre ne rrethana te caktuara, duke pasur si synim zbatimin e ne kohe dhe ne cilesi te kontrates objekt prokurimi.

Kerkesat per makinerite/mjetet qe nevojiten argumentohet ne baze te zerave te preventivit:

NR.	MJETET	SASIA (COPE)	STATUSI	SHËNIME
1.	Autoveteshkarkuese 10 ton min	1	Në pronësi ose me qera	Per zerat e punes nr.9(analize 2.37/5b),12(analize 2.37/2a),14 (analize 2.37/5b) 23(analize2.37/5a)
2.	Buldozer 100k/f	1	Në pronësi ose me qera	Per zerat e punes 8(analiza 3.352),13,20,28,
3.	Ekskavator me goma me kove 0.25 m3	1	Në pronësi ose me qera	PER ZERIN 12,23 te preventivit
4.	Betoniere 500 l	1	Në pronësi ose me qera	PER ZERIN 24, 42 te preventivit
5.	Rul me vibrim, rul me dhembe, rul me cilindrik(duke u kombinuar)	1	Në pronësi ose me qera	PER ZERIN 6 (analiza 3.47/1b), 7 (analiza 3.193/a) 13,19,20,28 te preventivit
6.	Grejder	1	Në pronësi ose me qera	PER ZERIN 18,19,30, te preventivit
7.	Tokmak elektrik	1	Në pronësi ose me qera	Per zerat e punimeve ne kap.III “Kurora”

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar).

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga subjekti i kontraktuar projektues (operatori ekonomik E.B.S shpk me të cilën autoriteti kontraktor ka lidhur kontratë për hartimin e projektit), dhe çdo material tjetër teknik, bashkëngjitur DST në SPE.

Kriteret e vecanta të kualifikimit që lidhen me kapacitetin teknik janë hartuar nga specialisti i fushës pjesë e njesisë së prokurimit, duke u bazuar në projektin, preventivin dhe grafikun e punimeve të objektit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Njësia e prokurimit: